



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë solemne e Kuvendit

P- 040

Prishtinë, më 17 tetor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 17 TETOR 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Seanca i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Rezolutës për adoptimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit

Kryetari, pasi përshëndeti Presidentin dhe Kryeministrin e Kosovës, përfaqësuesin e fushatës së Mijëvjeçarit, përfaqësuesit e korit diplomatik, si dhe të pranishmit e tjerë në seancë, mbajti një fjalë hyrëse lidhur me synimet e Deklaratës së Mijëvjeçarit.

Në vazhdim, Kryetari tha se bota e sotme vazhdon të ketë dallime të mëdha shoqërore dhe ekonomike. Me qëllim të zhdukjes së varfërisë së skajshme dhe të urisë nga të cilat vuajnë rreth

një miliard njerëz, të arritjes së shkollimit fillor për të gjithë, të promovimit të barazisë gjinore dhe të rritjes së rolit të gruas, të zvogëlimit të vdekshmërisë së foshnjave, të përmirësimit të shëndetit të nënave, të luftimit të sëmundjeve ngjitëse, të sigurimit të qëndrueshmërisë së ambientit dhe të krijimit të partneritetit global, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 2000 ka miratuar Deklaratën e Mijëvjeçarit, të cilën e kanë nënshkruar 189 vende.

Objektivat për zhvillimin e Mijëvjeçarit, synojnë arritjen e disa standardeve, të cilat do të sigurojnë zhvillim dhe përmirësim të jetës së shoqërive të vendeve të përfshira në këtë proces. Orientimi botëror i Mijëvjeçarit ka për qëllim zhdukjen e hendeqeve dalluese brenda shoqërisë moderne dhe krijimin e kushteve të mirëqenies së përgjithshme.

Deri më 2015 të gjitha vendet, me forcat e veta, si dhe me përkrahje nga jashtë, synojnë tejkalimin e vështirësive që lidhen me zhvillimin e tyre njerëzor e ekonomik dhe përgjysmimin e varfërisë ekstreme, shkollimin elementar, reduktimin në tri të katërtat të vdekshmërisë së foshnjave, zmbarsjen e sëmundjeve ngjitëse e të tjera.

Kuvendi i Kosovës dëshiron ta adoptojë Deklaratën e Mijëvjeçarit nëpërmjet Rezolutës së propozuar për miratim.

Kuvendi do të angazhohet për arritjen e objektivave për zhvillimin e Mijëvjeçarit dhe do të mbështesë institucionet e tjera, si dhe shoqërinë civile në këtë drejtim, sepse këto synime të përbashkëta kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, integrimin evropian të tij dhe partneritetin ndërkombëtar.

Pastaj, Kryetari ftoi Presidentin e Kosovës ta marrë fjalën.

Presidenti **Fatmir Sejdiu** tha se miratimi i Deklaratës së Mijëvjeçarit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkushtimin e institucioneve tona për realizimin e parimeve dhe të vlerave, të cilat do të mundësojnë që edhe vendi ynë të bëhet pjesë e progresit më të madh dhe të integrimi më të shpejtë.

Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit përmbajnë objektiva thelbësore që u detyrohen si institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, po ashtu edhe shteteve veç e veç. Prandaj, Kosova si shtet sovran dhe i pavarur, pavarësisht se është më i riu në hartën politike të botës, e merr me përkushtim realizimin e këtyre Objektivave të përbashkëta botërore duke pasur vizionin mbi nevojën e masave konkrete, të shpejta dhe të koordinuara në partneritet ndërkombëtar.

Ne jemi të vetëdijshëm për ndërvlarshmërinë midis rritjes ekonomike, reduktimit të varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, do të jetë me interes që Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të inkorporohen në mënyrë adekuate në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, si dhe në të gjitha strategjitë e tjera përcjellëse në nivel të ministrive dhe të fushave të tjera përkatëse.

Politikat më aktive zhvillimore dhe sociale nënkuptojnë doemos edhe shtimin e formave të bashkëpunimit me institucionet dhe entitetet ndërkombëtare, për të tejkaluar problemet dhe gjendjen ekzistuese të pakënaqshme.

Deklarata e Mijëvjeçarit na obligon që parimet e saj të reflektojnë edhe në buxhetin e Kosovës, sikur edhe në buxhetet e vendeve të tjera. Ju inkurajoj me këtë rast juve dhe të gjitha institucionet e Kosovës që, duke u mbështetur në Deklaratën e Mijëvjeçarit, të punohet për një ndërlidhje aktive në raportet strategjia zhvillimore – buxheti dhe bashkëpunimi me mediat dhe shoqërinë civile, me ç'rast do të mundësohej krijimi i linjave dhe i aktiviteteve të përbashkëta në relacionin institucionet - mediat - shoqëria civile dhe publiku, si një parakusht i rëndësishëm për realizimin e Objektivave të Mijëvjeçarit.

Realizimin e Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015, krahas përmbushjes së kriterëve për integrim në Bashkimin Evropian, e vlerësojmë si sfidë shumë të madhe, por edhe detyrim të mundshëm për t'u realizuar në pikat e veta më të ndjeshme.

Unë, si President i vendit, do të angazhohem dhe do të punoj për realizimin e plotë të këtyre obligimeve, duke u kujdesur për ndërlidhjen e të gjitha veprimeve jo vetëm në rrafshin e brendshëm, por edhe në atë të jashtëm.

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se Republika e Kosovës, si shtet i ri ka përgjegjësi jo vetëm brenda kufijve të saj, por edhe ndaj familjes së shteteve sovranë dhe bashkësisë ndërkombëtare, me të cilat ndanë obligimin për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar në nivelin rajonal dhe atë global.

Deklarata e Mijëvjeçarit, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 8 shtator 2000, dhe e mbështetur nga 189 shtete të botës, është në përputhje me vizionin tonë në pikëpamje të parimeve dhe të vlerave të dinjitetit njerëzor, të barazisë dhe të përbashkësisë së të gjithë qytetarëve të shtetit tonë.

Parimet e Deklaratës së Mijëvjeçarit kërkojnë që zhvillimi të bazohet në qeverisje të mirë, transparente dhe demokratike, sundim të ligjit dhe respektim të të drejtave të njeriut, standarde këto që tanimë i kemi instaluar në Kosovën e pavarur. Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës do të angazhohen për:

- sigurimin e mundësisë për jetë me dinjitet, të lirë, pa uri, pa frikë dhe trysni të çfarëdo lloji,
- krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët,
- sigurimin e klimës së tolerancës dhe të diversitetit fetar, kulturor dhe gjuhësor, në të cilin do të sigurohet dialogu i mirëfilltë midis qytetarëve,
- shfrytëzimin e përgjegjshëm i burimeve natyrore për zhvillimin e qëndrueshëm për brezat që do të vijnë,
- marrjen e përgjegjësi për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik.

Republika e Kosovës, prej sot, merr zyrtarisht obligimet e saj për përmbushjen e këtyre objektivave.

Objektivat e Mijëvjeçarit i kontribuojnë zhvillimit dhe progresit në mbështetje të nismës globale për paqe dhe stabilitet në tërë botën.

Qeveria e Kosovës do të veprojë në drejtim të krijimit të mundësive më të mira për sektorin privat, të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, që vlerat e përmendura të bëhen pjesë e vizionit, të strategjisë dhe të veprimtari të tërë shoqërisë dhe të institucioneve kosovare.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë Rezolutën.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Projektit: “Fushata e Mijëvjeçari të Kombeve të Bashkuara” ta marrë fjalën.

Z. Guido Schmidt, në emër të Projektit, foli për rëndësinë e parimeve të Deklaratës së Mijëvjeçarit.

Në vazhdim, z. Schmidt tha se qëllimet e zhvillimit të Mijëvjeçarit ofrojnë një kornizë të rëndësishme politike dhe të sfidave me të cilat po ballafaqohet Kosova. Kosova ka popullsi të re dhe ata janë pasuri e veçantë e saj dhe këtu kanë nevojë për t’u shkolluar dhe për t’u ngritur, për avancimin e arsimimit të mesëm dhe modernizimin e planeve dhe të programeve mësimore, si dhe përfshirjen e teknologjisë informative dhe të formave të tjera të cilat janë të nevojshme.

Kosova ka vështirësi edhe në sektorin e shëndetësisë. Duhet të përcaktohet niveli i lartë i mortalitetit dhe ai duhet të zvogëlohet. Gjithashtu, sfidë është edhe TBC-ja dhe sëmundjet e ndryshme ngjitëse. Të gjitha këto mund të menaxhohen.

Vendet në gjithë botën kanë hartuar programe afatgjate lidhur me adresimin e problemeve shëndetësore dhe arsimore dhe përvojat nga këto programe të suksesshme mund të jenë shumë pozitive në Kosovë nëpërmjet agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Duke shfrytëzuar përvojën e tyre, Kosova mund të arrijë shumë.

Duhet të mobilizohet i tërë shteti dhe t’i analizojë këto qëllime si shumë të rëndësishme duke shfrytëzuar një mënyrë të thjeshtë dhe gjuhën e përditshme në mënyrë që publiku ta ketë të qartë se çka dëshiron të arrijë Qeveria dhe Kuvendi. Ky vizion duhet të jetë i qartë për të gjithë njerëzit dhe këto objektiva zhvillimore të Mijëvjeçarit duhet të përdoren për mobilizimin e shoqërisë civile të këtij vendi.

Përmbushja e qëllimeve zhvillimore duhet të bëhet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Qeveria mund të japë kontribut në shumë fusha dhe kur ajo të ketë nevojë për mbështetje ndërkombëtare, do ta ketë përkrahjen tonë.

Bashkësia ndërkombëtare do t’ju ndihmojë në ndërmarrjen e hapave në miratimin e kësaj rezolute dhe, në fund, dëshiroj ta uroj udhëheqjen e juaj për mbushjen e objektivave të Mijëvjeçarit.

Pastaj këtyre diskutimeve, Kryetari ftoi anëtarin e Kryesisë së Kuvendit, zotin Naim Maloku, ta paraqesë para deputetëve të Kuvendit tekstin e Projekt-Rezolutës.

Naim Maloku prezantoi tekstin e Projekt-Rezolutës.

Kryetari e hodhi në votim rezolutën. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----99,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi tekstin e Rezolutës, si vijon:

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke ndërtuar shtetin e ri, sovran dhe duke forcuar demokracinë funksionale;

Duke riafirmuar dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për obligimin e saj që t'i respektojë parimet dhe vlerat e marrëveshjeve ndërkombëtare;

Duke vlerësuar përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për një botë më të mirë, më të drejtë, më prosperuese dhe paqësore dhe me qëllim që aktivisht t'u kontribuojë këtyre përpjekjeve;

Duke besuar që adoptimi i Deklaratës së Mijëvjeçarit, nga e cila rrjedhin Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit, do të kontribuojë më tej në proceset e zhvillimit të Kosovës;

Duke pasur parasysh që Agjenda e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara është në përputhje me proceset e integritit evropian dhe duke rikonfirmuar edhe aspiratën tonë për integrim evropian;

Me bindje që arritja e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit do të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar;

Të vetëdijshëm që përmirësimi i mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Kosovës, nëpërmjet arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit do të ndihmojë vendin që të forcohet si burim i stabilitetit në vend dhe rajon;

Në frymë me parimet dhe vlerat e Kombeve të Bashkuara, dhe me përpjekje të shtuara që të arrijmë Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit,

Në seancën plenare të mbajtur më 17 tetor 2008, miratoi këtë

R E Z O L U T Ë

Për adoptimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit

1. Adopton Deklaratën e Mijëvjeçarit, sipas tekstit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara *A/RES/55/2* të aprovuar më 8 shtator 2000;
2. I kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës që të krijojë partneritete globale, si dhe mirëpret përkrahjen ndërkombëtare në mobilizimin e përpjekjeve dhe të burimeve drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit në Kosovë;
3. Inkurajon autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat që të përfshihen në procesin e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri më 2015;
4. Zotohet që të miratojë kornizën e nevojshme ligjore dhe të krijojë politika të duhura që mundësojnë përfshirjen dhe përmbushjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit përmes planit përkatës kombëtar për zhvillim;
5. Siguron mekanizma dhe kapacitete të duhura institucionale, si dhe burime financiare të cilat lehtësojnë arritjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit;

6. Mbanë seancë vjetore për të diskutuar përparimin e arritur në lidhje me Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit, bazuar në raportin e ofruar nga Qeveria, dhe
7. Inkurajon të gjitha autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat, që të kontribuojnë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale